# Syllabus i Lëndës: Praktika Pedagogjike II

| **Të dhëna bazike të lëndës** | |
|---|---|
| **Njësia akademike:** | **Fakulteti i Edukimit/ Programi MA në Mësimdhënien lëndore-Specializimi Biologji** |
| **Titulli i lëndës:** | Praktika pedagogjike II |
| **Niveli:** | Master |
| **Statusi i lëndës:** | E obliguar |
| **Viti i studimeve:** | II |
| **Numri i orëve në javë:** | 3+0 |
| **Vlera në kredi – ECTS:** | 5 |
| **Koha / lokacioni:** | Fakultet (E marte 14:00-16:15) dhe ne Shkollë |
| **Mësimëdhënësi i lëndës:** | Prof. asoc. dr. Zeqir Veselaj |
| **Detajet kontaktuese:** | 038 229021 E mail: Zeqir.veselaj@uni-pr.edu |

| | |
|---|---|
| **Përshkrimi i lëndës** | Mësimi praktik përfshinë dy komponente të ndara, por të lidhura ngushtë me njëra tjetrën:<br>•***Mësimin praktik në Fakultet*** (përgatitja teorike) i cili ka dy qëllime primare:<br>(i) t'u ofrojë studentëve përgatitjen që u duhet atyre për të qenë të suksesshëm në klasa, dhe<br>(ii) t'u ofrojë kohë dhe strukturë për reflektim dhe diskutim, për ta mundësuar nxënien nga koha që kanë kaluar në klasë.<br>• ***Mësimi praktik në shkolla*** i cili synon që studentët të zhvillojnë njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet e caktuara për të qenë mësimdhënës në nivelin e shkollës së mesme te ulët dhe/ose të lartë si dhe të zbatojnë strategji të ndryshme të cilat shpiejnë drejt zhvillimit të tyre si mësimdhënës.<br>Kjo pjesë përfshinë edhe zhvillimin e aftësive për të krijuar dhe menaxhuar një ambient kultivues dhe përkrahës të nxënies dhe për të planifikuar dhe mbajtur mësim sipas planprogramit të shkollës si dhe për t'u njohur me funksionimin e shkollës si organizatë. |
| **Qëllimi i lëndës** | Gjatë praktikës pedagogjike II, studentët do të zgjerojnë njohuritë për praktikat mësimore dhe për procesin e vëzhgimit të aktiviteteve në klasë. Procesi i vëzhgimit të aktiviteteve mësimore do të fokusohet në shkollat e mesme të ulta.<br>Qëllimi parësor i komponentës së mësimit praktik është që studentëve të Masterit për mësimdhënie lëndore (Biologji) t'u ofrohen mundësitë për të zhvilluar shkathtësitë për planifikimin dhe realizimin e mësimdhënies efektive në klasë, përfshirë edhe vlerësimin e nxënësve, dhe t'u ndihmojë atyre që të kuptojnë më mirë rolet dhe përgjegjësitë e mësimdhënësve brenda kulturës së shkollës dhe klasës.<br>Komponenta e mësimit praktik do të përfshijë edhe kohën e kaluar në ligjërata në aktivitete mësimi, edhe kohën e kaluar në klasa të shkollave.<br>Gjatë praktikës pedagogjike II, studentët duhet të angazhohen në secilin nga aktivitetet në klasë.<br>- Studentët duhet të shënojnë *planifikimet dhe reflektimet* në ditarët e |

| | |
|---|---|
| | tyre për aktivitetet në të cilat kanë marrë pjesë.<br>- *Plan programi mësimor* (studentët duhet të vëzhgojnë se si e përdor mësimdhënësi plan programin për planifikim).<br>- *Ditari i klasës* (studentët duhet të njihen me ditarin e klasës).<br>- *Tekstet mësimore dhe materialet tjera mësimore në klasa*. (Studentët duhet të njihen me materialet që përdoren për mësimdhënie dhe të nxënit).<br>- *Aktivitetet jashtë-mësimore* (studentët duhet te marrin pjesë në aktivitetet jashtë klasës dhe të bëhen të vetëdijshëm për aktivitetet e nxënësve në situata të tilla). |
| **Rezultatet e pritura të nxënies:** | Në fund të kursit student do të jetë në gjendje të:<br>- planifikoj realizimin e objektivave dhe rezultateve të të nxënit të Kurikulës Bërthamë 2 për fushën e shkencave të natyrës- lënda Biologji;<br>- zbatoj metodologjinë e mësimdhënies së biologjisë në klasë përfshirë planifikimin e punës individuale, në çifte dhe grupore të nxënësve;<br>- organizoj klasën sipas tipit të orës që zhvillon, përfshirë motivimin dhe ndërtimin e raporteve bashkëpunues mes tyre;<br>- merr pjesë në aktivitete mësimore përmes ofrimit të asistencës teknike, krijimit dhe shfrytëzimit të mjeteve mësimore, këshillave dhe udhëzimeve për nxënësit.<br>- reflektoj në mënyrë të vazhdueshme dhe kritike mbi punën e tij dhe të nxënësve në klasë përmes ditarëve reflektiv |

**Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)**

| Aktiviteti | Orë | Ditë/javë | Gjithësej |
|---|---|---|---|
| Ligjërata | 3 | 15 | 45 |
| Ushtrime teorike/laboratorike | | | |
| Punë praktike | | | |
| Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet | 2 | 2 | 4 |
| Ushtrime në teren | | | |
| Kollokfiume, seminare | | | |
| Detyra të shtëpisë | | | |
| Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë, shtëpi) | 2 | 15 | 30 |
| Përgaditja përfundimtare për provim | 2 | 15 | 30 |
| Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final) | 2 | 1 | 2 |
| Portfolio e studentit | 1 | 14 | 14 |
| **Totali** | | | **125** |

| | |
|---|---|
| **Metodologjia e mësimëdhënies:** | Ligjerata interaktive; Punë dhe konsultimet në grupe<br>Praktikë në shkollë; Reflektime ne fakultet dhe prezantimet |
| **Metodat e vlerësimit:** | Vlerësimi i mësuesit mentor ---------------------------------------30 pikë<br>Vlerësimi përfundimtar i mësimdhënësit-------------------------30 pikë |

| | |
|---|---|
| | Detyra në klasë-----------------------------------------------------10 pikë<br>Ditari reflektiv i studentit------------------------------------------10 pikë<br>Portfolio e studentit ----------------------------------------------10 pikë<br>Vijimi i rregullt në praktikë-----------------------------------------5 pikë<br>Prezantimi në minikonferencë--------------------------------------5 pikë<br><br>Vlerësimi përfundimtar do të realizohet nga të gjithë komponentet si dhe Formulari nga Doracaku i praktikës.<br>Studenti vleërsohet me: **kalon/nuk kalon.** Pragu i kalueshmërisë është zotërimi i **70 pikë** të komponenteve vlerësuese të praktikës pedagogjike. |
| Literatura | |
| **Literatura bazë:** | A) Literatuara e obliguar:<br>- Fakulteti i Edukimit (2017), Doracaku për mësimin praktik. Burimi: https://edukimi.uni-pr.edu/getattachment/aec0100e-825e-4d89-a371-2b54e23ebc21/Doracaku-per-mesim-praktik.aspx<br>- MASHT (2016). Korniza e Kurrikulës së Kosovës<br>Burimi: https://masht.rks-gov.net/uploads/2017/03/korniza-kurrikulare-finale.pdf<br>- MASHT (2016). Kurrikula Bërthamë 2 (Shkencat natyrore- Biologji)-<br>Burimi: https://masht.rks-gov.net/uploads/2017/03/korniza-berthame-2-final.pdf |
| **Literatura shtesë:** | B) Literatura shtesë<br>Artikuj mbi shkrimin reflektiv, ditarin e studentit dhe vetëvlerësimin (te rekomanuara nga profesori i lëndës) |

| **Plani i detajuar i mësimit:** | |
|---|---|
| **Java** | Ligjerata që do të zhvillohet |
| **Java e parë:** | Përshkrimi i kursit. Rëndësia e ndërlidhjes së teorisë me praktikën mësimore. Literatura: Doracaku për mësimin praktik 2017. |
| **Java e dytë:** | Korniza e Kurrikulit të Kosovës dhe Kurrikulat bërthamë- Zbatimi në praktikë<br>Literatura: Udhëzues praktik për zbatimin e kurrikulës (Fusha e kurrikulës: Shkencat e natyrës- Koncepti: Bota e gjallë) |
| **Java e tretë:** | Kuptimi dhe funksioni i rezultateve të të nxënit në shkencat e natyrës.<br>Literatura: Udhëzues praktik për zbatimin e kurrikulës (Fusha e kurrikulës: Shkencat e natyrës- Koncepti: Bota e gjallë) |
| **Java e katërt:** | Aspektet metodologjike dhe praktike të planifikimit të mësimit në shkencat e natyrës.<br>Literatura: Udhëzues praktik për zbatimin e kurrikulës (Fusha e kurrikulës: Shkencat e natyrësë Koncepti: Bota e gjallë) |

| | |
|---|---|
| | Literatura: Doracaku për mësimin praktik 2017. |
| **Java e pestë:** | Metodologjia e mësimdhënies së biologjisë. Organizimi i klasës dhe materialet e nevojshme.<br>Literatura: Doracaku për mësimin praktik 2017 dhe MASHT: Kurrikula Bërthamë 2 (Shkencat natyrore- Biologji) |
| **Java e gjashtë:** | Udhëzimet për vlerësimin e nxënësve në shkencat e natyrës- Biologji.<br>Literatura: Doracaku për mësimin praktik 2017 dhe MASHT: Kurrikula Bërthamë 2 (Shkencat natyrore- Biologji) |
| **Java e shtatë:** | Mësim praktik në shkollë (e hënë – e premte) |
| **Java e tetë:** | Mësim praktik në shkollë (e hënë - e premte) |
| **Java e nëntë:** | Mësim praktik në shkollë (e hënë – e premte) |
| **Java e dhjetë:** | Mësim praktik në shkollë (e hënë - e premte) |
| **Java e njëmbedhjetë:** | Reflektime mbi orët më simore -fokusimi tek rezultatet e të nxënit në mësimdhënien e biologjisë |
| **Java e dymbëdhjetë:** | Reflektime mbi orët mësimore -fokusimi tek planifikimi i orës së biologjisë |
| **Java e trembëdhjetë:** | Reflektime mbi orët mësimore -fokusimi tek metodat /teknikat e mësimdhënies, organizimi i klasës dhe vlerësimi në lëndën e biologjisë |
| **Java e katërmbëdhjetë:** | Prezantimi i portfoliove nga puna praktike dhe vlerësimi- Minikonferencë |
| **Java e pesëmbëdhjetë:** | Prezantimi i portfoliove nga puna praktike dhe vlerësimi- Minikonferencë |

| **Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:** |
|---|
| Mësimi praktik është komponentë përbërse e programit studimor për përgatitjen e mësimdhënësve lëndor.<br><br>Studenti gjatë punës praktike duhet tu përmbahet në mënyrë rigoroze politikave dhe procedurave të miratuara në Doracakun e Mësimit Praktik për programet Master Lëndor të Fakultetit të Edukimit. |